



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 36.
Prishtinë, më 21.03.2012 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, , Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik Glauk Konjufca, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Elita Vokshi, Lejla Selimi përfaqësuese nga zyra Zvicerane Sakibe Jashari.. përfaqësuese nga Ambasada Amerikane- Maja Marinkovic, përfaqësues nga zyra e KDI-së Shkumbin Beqiri, Elizabet Gj. dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 6.03.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-99 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave , me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-104 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.**
9. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.**
10. **Te ndryshme**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – informoi komisionin se pika e tretë e rendit të ditës, Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor do të shtyhet për mbledhje të radhës.

Dha sqarim se lidhur me këtë çështje të ndjeshme, Komisioni Funksional sërisht është në takim të përbashkët me palët e interesuara të cilët janë vendimmarrës, kryeministrin Hashim Thaqi dhe shefin e zyrës së ICO-së Piter Feih, ndërsa të dyja palët ende nuk kanë arritur konsus përfunduar.

Glauk Konjufca – Në falin e tij tha se gjatë shqyrtimit të projektligjeve nga pakoja buxhetore grupi jonë parlamentar ka dhënë propozim amendamente dhe se të njëjtat nuk janë përkrahur nga komisioni Funksional. Ai e njoftoi komisionin se për arsyet e lartë cekura nuk do të jep pëlqimin gjatë votimit të projektligjeve të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës me shumicë të votave dhe një abstenim, me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur me 6.03.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-99 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-99 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave dhe një abstenim, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-99 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente,

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave dhe një abstenim, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente.

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave dhe një abstenim, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave , me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente,

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave dhe një abstenim, nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave ,dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-104 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-104 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, dhe kërkoj që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente,

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesues, konstatoi se Komisioni me shumicë të votave dhe një abstenim, nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-104 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, dhe kërkoj që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Petar Miletic- në fjalën e tij tha se në fund kemi një raport finale nga komisioni FunkSIONAL në Projektligjit për Transmetimin Publik në Kosovë.

Ai shprehu mendimin e tij se personalisht është i pa kënaqur me një pjesë të ligjit, kur bëhet fjalë për formimin e kanalit televiziv në gjuhën serbe. Lidhur me këtë çështje grupet parlamentare jo shumicë kanë dhënë propozim i cili është miratuar si amendament i komisionit për komunitete. Akordohet të tërhiqet ky propozim amendament pasi i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar nga komisioni funksional dhe se pajtohet të procedohet për Kuvend.

Dha sqarim se me hartimin e këtij amendamenti është dhënë mundësia që Bordi i RTK-së në bazë të kualifikimeve profesionale për punësim do të formoj grupin punues për përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

Anëtarët e komisionit, **Albert Kinolli** dhe **Myfera Sinik** konstatuan se propozim amendamenti i GP 6+ nuk është përkrah nga komisioni FunkSIONAL. Andaj kërkuan që i njëjti të marrë përkrahjen e Komisionit.

Petar Miletic- plotësisht pajtohet që nga komisioni të votohet propozim amendamenti i GP 6+ dhe i njëjti të inkorporohet në raport të komisionit FunkSIONAL, me apo pa përkrahje.

Glauk Konjufca- tha se nga grupi parlamentar ka dhënë propozime në amendamentin 16, në Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë dhe se të njëjtat nuk janë përkrahur nga komisioni FunkSIONAL. Theksoi se do të abstenon- (jetë i përmbajtur) gjatë votimit të raportit final të komisionit FunkSIONAL.

Kryesuesi- konstatoi se pas diskutimeve të shumta, Komisioni miratoi amendamentin e GP 6+ me shumicë të votave për- dhjetë (10), dhe dy (2) abstenim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pas shqyrtimit të Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me shumicë të votave, për – njëmbëdhjetë (11) dhe një (1) abstenim, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. (A) Komisioni i ka shqyrtuar Amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe të njëjtat janë përkrah në tërësi.
(B) Komisioni shqyrtoi amandamentin 6 të propozuar nga GP 6+, dhe i njëjti u përkrah.
- III. Në bazë të asaj që u tha më lartë, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim i rekomandon Kuvendit që ta miratojë projektligjin së bashku me amendamentin e përkrahur. .

9. Të ndryshme.

Kryesuesi – e njoftoi komisionin se pas përfundimit të mbledhjes, Komisioni në përbërje të plotë do të ketë dreke pune ku do të diskutohet për pikat e agjendës për organizimin e vizitës në shtetin Federal të Zvicrës .

Njëherit do të caktohen edhe datat për realizimin e vizitës në Kuvendin Komunal Ranillug dhe Komunën e Shtërpçës. Për takimin dhe agjendën e vizitës, komisioni do të njoftohet me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic